



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 97, Datë 23/07/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 46, datë 15.05.2019, e Z. F.F., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Z. F.F. ka lindur në datën 13.02.1942, në Ersekë dhe aktualisht është pensionist dhe banor i qytetit të Korçës. Ankuesi informon se ndodhet në gjendje të rëndë, shëndetësore¹. Në vitin 2012 ka pësuar hemorragji cerebrale, e cila është përsëritur në vitin 2014, duke lënë si pasojë paralizë të pjesëshme tek ankuesi. Në vitin 2018, Z. F.F. është diagnostikuar me sëmundjen Parkinson dhe gjendja e tij shëndetësore në tërësi është rënduar edhe më tepër. Ankuesi pretendon se nuk është i aftë të kujdeset për veten dhe të gjitha shërbimet ndaj tij kryhen nga bashkëshortja e tij. Z. F.F. pretendon të përfitojë shërbimin e kujdestarisë, por diagnoza e

¹ Referuar fletëdaljes së lëshuar nga QSUT (2014).

vënë nga Z. Ralfi Bitri, specialist neurolog pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, e ka kategorizuar si invalid të grupit të dytë, fakt ky që e penalizon për të përfituar shërbim kujdestarie pranë KMCAP Korçë. Ankuesi nuk bie dakord me faktin e sipërpërmendur dhe pretendon se diskriminohet për shkak të gjendjes shëndetësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 46, datë 15.05.2019, e Z. F.F., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, me shkresën nr. 735/1, datë 20.05.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - 1.** Kopje e fletës së diagnozës së lëshuar nga specialisti i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, për Z. F.F.;
 - 2.** Informacion, nëse Z. F.F. përfiton kemp me Vendim të KMCAP Korçë. Nëse po, të përcillen pranë KMD-së, të gjithë Vendimet e KMCAP Korçë të dhëna për të;
 - 3.** Informacion, nëse ankuesi ka aplikuar pranë KMCAP Korçë, për të përfituar shërbimin e kujdestarisë;
 - 4.** Informacion mbi grupin e invaliditetit, të cilit i përket Z. F.F.;
 - 5.** Kopje e dosjes së Z. F.F., që disponohet nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë;

Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijëni edhe ankuesit.

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 735/1, datë 20.05.2019, të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë ktheu përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 735/1, datë 20.05.2019, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në se me Vendim për Caktim Pensioni nr. 294, datë 27.03.1989, Z. Feim Hysni F.F. ka përfituar pension pleqërie nga data 06.03.1989, me masë fillestare të pensionit 576 lekë/muaj dhe 27 vjet 7 muaj vjetërsi pune gjithësej.

Sipas dokumentacionit që administrohet në dosje, Z. Feim Hysni F.F. nuk ka përfituar pension invaliditeti. Në dosje nuk ka fletë të diagnozës së lëshuar nga specialisti i DRSSH Korçë. Z. F.F. nuk përfiton pension invaliditeti me vendim të KMCAp-it, nuk ka aplikuar për të përfituar shërbimin e kujdestarisë, si dhe nuk ka dokumentacion nga KMCAp për grupin e invaliditetit. Në kushtet kur, ankuesi është përfitues i pensionit të pleqërisë, nuk mund të kërkojë pension invaliditeti sipas ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore i ndryshuar” (i ndryshuar).

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 46, datë 15.05.2019, e Z. F.F., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ankuesi F.F. pretendon diskriminim për shkak “gjendjes shëndetësore”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë. Z. F.F. pretendon se ka kërkuar të përfitojë shërbimin e kujdestarisë, por diagnoza e vënë nga Z. Ralfi Bitri, specialist neurolog pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, e ka kategorizuar si invalid të grupit të dytë, fakt ky që e penalizon për të përfituar shërbim kujdestarie pranë KMCAp Korçë.

Për sa më sipër, nga korrespondenca zyrtare me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore që Komisioneti pati në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese, rezultoi se ankuesi nuk përfiton pension invaliditeti me Vendim të KMCAp-së dhe nuk ka aplikuar asnjëherë për të përfituar shërbim kujdestarie pranë këtij institucioni. Njëkohësisht, në shkresën zyrtare të DRSSH Korçë theksohet fakti se Z. F.F. nuk mund të përfitojë asnjëherë prej ndihmave ekonomike të sipërpërmendura, pasi që prej vitit 1989 përfiton pension pleqërie, dhe dispozitat e ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore i ndryshuar” (i ndryshuar) nuk e mundësojnë një gjë të tillë.

Për sa më sipër, në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore i ndryshuar” (i ndryshuar) parashikohet: “Personi që bëhet i paaftë merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë: a) për çdo veprimtari ekonomike; b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë.....”.

Ndërkohë që në nenin 38 të të njëjtit ligj parashikohet: “Kur përfituesi i një pensioni invaliditeti bëhet fizikisht ose psikikisht i paaftë dhe kanevojë për një kujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 përqind të bazës së vlerësuar neto. Nevoja për kujdesje të vazhdueshme e një personi tjetër përcaktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP)”.

Në këtë kontekst, rezulton se pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorive Rajonale të këtij institucioni mund të kërkojnë për të përfituar pension invaliditeti, të gjithë ata individë, të cilët janë në moshë për punë dhe u ka humbur aftësia për punë, si pasojë e aksidenteve apo sëmundjeve të ndryshme, por jo ata individë, të cilët përfitojnë pension pleqërie. Pensioni i invaliditetit, sikurse edhe pagesa për shërbim kujdestarie përfitohen vetëm me vendim të KMCAP-së.

Mbështetur në statusin e ankuesit, Komisioneri i rekomandon të paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, ku do të udhëzohet mbi mënyrat ligjore, për të përfituar kemp dhe shërbim kujdestarie, sipas parashikimeve të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar).

Në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Z. F.F. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë. Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ka diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Z. F.F., për shkakun e pretenduar në ankesë, nga Drejtoria Rajonale e e Sigurimeve Shoqërore Korçë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – te mira e sherbime
Shkak – aftesi e kufizuar